

**AKTI I THEMELIMIT I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Sunny Hill” shpk**

Sot, Më datë 16/06/2022, shoqëria krijohet nga ortakët themelues:

**Limoza Metaj**, shtetase shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal H25217090M, i datëlindjes 17/02/1972, lindur në Lezhan dhe banuese në Vlorë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Lavdosh Bala**, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal F40922043O i datëlindjes 22/09/1954, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 1:**  
**Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “**Sunny Hill**” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:**  
**Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e :

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike solare (fotovoltaike, energjisë së erës (eolike) dhe energjisë gjeotermale në Republikën e Shqipërisë dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Ministrive e Institucioneve të shtetit shqiptar i të gjitha miratimeve, lejeve dhe licencave të cilat mundësojnë zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyre të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë si dhe shërbime të tjera të ngjashme ose të lidhura me sa me sipër të cilat nuk ndalohen me ligj në Shqipëri dhe çdo lloj veprimtarie të ligjshme.

2) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3:**  
**Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:**

*Faqe 1 e 3*  
*Akti i Themelimit*  
*“Sunny Hill” shpk*



## **Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga Zhan D'Ark , Ndërtesa 18, Nr.ap 41, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

## **Neni 5:**

### **Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 (dhjetëmijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota dhe nuk është paguar. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

Znj.Limoza Metaj: Zotëruese e një kuote me vlerë të përgjithshme 5,000 lekë që përben 50% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

Z.Lavdosha Bala Zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 5,000 lekë që përben 50% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 2) Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta).

## **Neni 6:**

### **Administratori**

- 1) Administratore e shoqërisë emërohet Znj.Limoza Metaj, shtetase shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal H25217090M e datëlindjes 17/02/1972, lindur në Lezhan dhe banuese në Vlorë, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

## **Neni 7:**

### **Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


## **Neni 8:**

### **Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**ORTAKËT E SHOQËRISË  
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Sunny Hill" shpk**

**Limoza Metaj**  
(Emër, Mbiemër, Firma)

Limoza Metaj  


**Lavdosh Bala**  
(Emër, Mbiemër, Firma)

LAVDOSH BALA  
